

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministerstvo za Financije
Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo
Departmenti i Ankesave
Nr. Prot. 479/22 Data 09/12/2022
PRISHTINE



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve - Ministerstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



ADMINISTRATA TATIMORE e KOSOVËS (ATK) – Divizioni i Ankesave respektivisht zyrtarja e ngarkuar me rastin Ilona Mrasori, duke vendosur në çështjen administrative tatimore sipas ankesës së subjektit [redacted] me numër unik identifikues (NUI): [redacted] me pronare [redacted], me seli të biznesit adresa: [redacted] e dorëzuar në Divizionin e Ankesave me datë 17/11/2022 me nr. të protokollit 479/22, në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat kundër vendimit mbi Njoftim-Rivlerësimet për Tatimin Shtesë, të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Prishtinë -2, në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 03/L-222 „Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”, mori këtë:

VENDIM

L.Hedhet si e pa afatshme ankesa me nr. 479/22 e subjektit tatimor [redacted] me NUI [redacted] me seli të biznesit fs [redacted] në mbështetje të nenit 129, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, pasi që ankesa është dorëzuar pas kalimit të afatit ligjor për dorëzim.

Arsyetim

Divizioni i Ankesave bazuar nga të dhënat në lëndën e dorëzuar nga tatimpaguesi konstaton se ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse tatimpaguesi me datë 17/10/2022 ka pranuar njoftim vlerësimet (dokument ky i dorëzuar tatimpaguesit përmes emailit), lëshuar nga Drejtoria Rajonale Prishtina 2 , ndërsa tatimpaguesi ankesën me shkrim e ka dorëzuar në Divizionin e Ankesave me datën 17/11/2022 e protokolluar me nr. 479/22.

Afati për paraqitjen e ankesës ka qenë 30 ditë pas pranimit të përcaktimit zyrtar, bazuar në paragrafin 2 të nenin 77 të Ligjit Nr.03/L-222, Për Administratën Tatimore dhe Procedura dhe paragrafit 7 të nenit 44 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2010, dita e fundit e afatit për

paraqitjen-dorëzimin e ankimit organit drejtpërdrejtë apo me anë të postës ka qenë data 16/11/2022, ndërsa paragrafi 7 i nenit 44 i Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 parasheh se nëse fundi i periudhës 30 ditore është ditë pushimi apo festë zyrtare, periudha 30 ditore do të përfundoj në ditën e parë pas ditës së pushimit ose festës.

Sipas paragrafi 3 të nenit 77 të Ligjit Nr.03/L-222 si dhe paragrafit 8 të nenit 44 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, me rastin e dorëzimit të ankesës me shkrim, tatimpaguesi nuk ka dorëzuar dëshmi me shkrim për të përshkruar rrethanat që i kanë pamundësuar parashtrimin e ankesës me kohë, apo padrejtësinë që do të rezultonte nëse ankesa nuk dëgjohej.

Pasi që ankesa është parashtruar pas kalimit të afatit prej 30 ditësh, konsiderohet e njëjta është e pa afatshme dhe nuk mund të shqyrtohet.

Nga arsyet e theksuar më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në paragrafi 2 të nenin 77 të Ligjit Nr.03/L-222, "Për Administratën Tatimore dhe procedurat", dhe nenin 129, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën Administrative.

KËSHILLA JURIDIKE: Bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 03/L-222, Tatimpaguesi i pakënaqur ka të drejtë që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të vendimit të Departamentit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë vendim tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE PRISHTINË
Nr.479/22 datë 09/12/2022

Vendimi t'iu dorëzohet :

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi

Kryesuese e rastit
Ilona Mrasori

